

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË**-Departamenti i Përgjithshëm, më Gjyqtaren Ilirjana Hoti dhe sekretaren juridike Flutur Nagavci, në lëndën penale kundër të akuzuarit **S.R.** nga fsh. R. KK Gjakovë, për shkak të veprës penale falsifikim i dokumenteve neni 398 prg.1 të KPRK-së, sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore Departamenti – Përgjithshëm në Gjakovë, PP/II.nr.1850/2014 të dt. 29.03.2016, duke vendosur në lidhje me propozimin e PTHDP-Gjakovë, për dhënien e urdhrit ndëshkimor, jashtë shqyrtimit gjyqësor, me dt.**07.07.2016**, murr ketë:

**A K T G J Y K I M**

**PRANOHET** kërkesa e PTH-DP ne Gjakovë PP/II.nr.1850/2014 e dt.29.03.2016,dhe kjo Gjykatë, jep këtë :

**URDHËR NDËSHKIMOR**

I akuzuari:

**S.R.** i lindur me dt... në Gj. tani me banim në fsh. R. KK Gjakovë, i biri i M. dhe nënës A. e gjinisë R. i martuar, at i 4 fëmijëve, ka të kryer shkollën e lartë pedagogjike, postier, i gjendjes së varfër ekonomike, shqiptar, shtetas i R. Kosovës.

**Ë s h t ë f a j t o r**

**Sepse :**

Më dt.11.07.2014, është mbajtur shqyrtimi gjyqësor në Gjykatën Themelore në Gjakovë-Departamenti për Krime të Rënda, me ç ‘rast të dëmtuarit E.(Z)R. i cili është babai i tani të ndjerit A.(E).R. nuk iu është mundësuar pjesëmarrja në shqyrtimin gjyqësor, për faktin se i akuzuari S.(M).R. shpërndarës i Postës në fshatin C. KK Gjakovë, nuk ia ka dërguar ftesën e Gjykatës të dëmtuarit, duke u nënshkruar vetë në flete kthesë, me qëllim që kinse i dëmtuari e ka pranuar me kohë ftesën dhe në mënyrë që shqyrtimi të mbahet në mungesë të të dëmtuarit E.R.

**-me çka ka kryer veprën penale falsifikim i dokumentit nga neni 398 par. 1 të KPRK-së.**

Andaj, Gjykata komfor nenit 4,41,43, 46,73,dhe nenit 398/1 te KPRK-së ,si dhe nenit 495 te KPPK-së të akuzuarin e,

**G J Y K O N**

**S.R.** i cakton dënimin me gjobë në shumë prej **200,00 € (dyqind euro)**, të cilën shumë është i obliguar që ta paguaj në afat prej **15 ditësh**, pas plotfuqishmërisë, së këtij Aktgjykimi -Urdhri ndëshkimor, në kërcënim të përmbarimit me dhunë.

Nëse, dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet as me detyrim dhe në forma të tjera të parapara sipas nenit 46 të KPK-së, atëherë i njëjti dënim në bazë të nenit 49 par.4 të KPPK-së , do ti zëvendësohet me dënim burgimi në kohëzgjatje prej **10 (dhjetë)ditësh**, duke llogaritur për çdo ditë burgu nga **20 € (njëzet euro)**.

I akuzuari obligohet që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej **30,00 €**, e këtë në afat prej **15 ditësh** pasi që Aktgjykimi-urdhri ndëshkimor të merr formë të prerë, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

## A r s y e t i m

Pranë kësaj Gjykate Prokuroria Themelore - Departamenti i Përgjithshëm në Gjakovë, ka ngrit Aktakuzën PP/II.nr.1850/2014 e dt.29.03.2016, ndaj të akuzuarit S. R. nga fsh. R. KK Gjakovë, për shkak të veprës penale falsifikim i dokumenteve nga neni 398/1 të KPRK-së.

Komfor nenit 493 të KPPK-së, PTH në Gjakovë, kësaj Gjykate i ka propozuar që ndaj të akuzuarit të lartcekur, pa mbajtur shqyrtimin gjyqësorë, të nxjerr urdhër ndëshkimor dhe të njëjtit t'i shqiptohet dënim me gjobë.

Para se të vazhdohet me arsyetim të Aktgjykimit për palët e pa udhëzuara është e nevojshme që t'i referohet dispozitës së nenit 398/1 të KPRK-së e cila dispozitë për kryesin e kësaj vepre penale parasheh dënim me gjobë ose me burgim gjerë në 3(tri) vite.

Gjykata me rastin e shqyrtimit paraprak të çështjes komfor nenit 495 të KPPK-se, gjeti se janë plotësuar kushtet nga dispozita e nenit 493 të KPPK-se dhe pa mbajtur shqyrtimin gjyqësor, vendosi që të pranoi kërkesën e PTH –se në Gjakovë, për dhënien e urdhërit ndëshkimor dhe të shqiptoj ndaj të akuzuarit dënim me gjobë si në dispozitiv të Aktgjykimit .

Gjykata vlerëson se provat që i janë bashkangjitur propozimit për dhënien e urdhrit ndëshkimor të cilat gjinden në shkresat e lëndës siç janë:

- Deklarata e të dëmtuarit E.(Z).R. e dhënë në Prokurorinë Themelore në Gjakovë me dt.03.06.2015,
- Deklarata e të dyshuarit S.(M.).R. e dhënë në Prokurorinë Themelore në Gjakovë me dt. 08.06.2015,
- Shkresat tjera në lëndë.

Shkresat e lëndës janë prova të mjaftueshme me të cilat argumentohet se i akuzuari është kryes të veprës penale për të cilën akuzohet.

Gjykata këtë dënim e ka shqiptuar me bindje se me të njëjtit do të arrihet qëllimi i dënimit të paraparë në nenin 41 të KPRK-së në mënyrë që të parandaloi kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tyre, si dhe të përmbaj personat tjerë nga kryerja e veprave penale.

Vendimi për udhëzimin e palës së dëmtuar në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike është marr bazuar në nenin 463/2 të KPP-ës.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale u murr komfor nenit 450 par.2 dhe pika 2.1 dhe 2.6 të KPPK-së.

Me sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi mbi urdhrin ndëshkimor.

### **GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË**

**P.nr.173/16 te dt. 07.07.2016**

**Sekretarja juridike:  
Flutur Nagavci**

**Gjyqtarja  
Ilirjana Hoti**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij Aktgjykimi është i lejuar kundërshtimi në afat prej **8 ditësh**, nga dita e marrjes së të njëjtës ,Gjyqtares të kësaj Gjykate. Nëse e pandehuri nuk ushtron kundërshtim, Aktgjykimi do të merr formë të prerë.